



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena / Prilato Received / Delivered	13 - 10 2022	2	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jednica Org./Unit	Pr. Prof. Pr. Pr. 4 Prof. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SANKSION	6159/2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.747/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.747/2022 të datës 30.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi pa numër, Prishtinë, kundër Vendimit KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës-harmonizim i koeficientit të pagës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa A.nr.747/2022 e datës 30.08.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. *Anulohet* Vendimi KA.Nr.26/2022 i datës 11.08.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokuroria të Kosovës dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje* të organi i njëjtë.
- IV. *Obligohet* Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për zbatimin e vendimit siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial, me datë 30.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5032/2022 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material, shkëljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative si dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 12.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 5032/2022 të datës 30.08.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të protokollit 401/2021 të datës 18.03.2021 nga ankuesja; E-malin e datës 25.05.2022 nga ankuesja për E-mailin e datës 08.12.2021 nga ankuesja për E-malin e datës 29.03.2022 nga për ankuesen; E-mailin e datës 18.03.2021 nga për Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 1215/2022 të datës 15.10.2022 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore për ankuesen; Ankesën e datës 25.07.2022 të ankueses e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së; Vendimin me numër KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; E-malin e datës 11.08.2022 nga për ankuesen; Vendimin me numër KPK/Nr.459/2020 të datës 23.09.2020 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për harmonizimin dhe nivelizimin e koeficienteve; Akt Emërimit me numër DBNJ/DSKPK-008/2019 të datës 02.09.2019; Shkresën me titull Aprovimin e titujve të punës-Këshilli Prokurorial i Kosovës me numër me referencën DASHC/MAP-04/240 e datës 28.10.2018; Shkresën e DASHC/MAP-04 (data nuk shihet) lidhur me procedimin në sistemin e pagave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5058/2022 të datës 01.09.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 5312/2022 të datës 12.09.2022; Konkursin e brendshëm (avancim në karrierë) me Referencën: Kodi: KPK/SKPK/POZ-007 i datës 10.07.2019 për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Pagave; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër DBNJ/DPSKPK/818/2020 i datës 01.10.2020; për pozitë Udhëheqës i Zyrës Ligjore; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër DBNJ/DPSKPK/820/2021 i datës 15.03.2021 për pozitë Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Zyrës Ligjore, Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun dhe Udhëheqës i Zyrës së Pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku ka konstatuar që *çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi të Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokuroria , SEPSE:*

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhe së ankuesja është e punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe së e njëjta sipas Akt-it të Emërimit me numër



DBNJ/DSKPK-008/2019 të datës 02.09.2019 është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës *Udhëheqëse e Zyrës së Pagave*.

Ankuesja më datë 18.03.2021 i është drejtuar me shkrim U.d Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më kërkesën për trajtim të barabartë dhe ngritje të koeficientit të pagës nga dhjetë (10) në trembëdhjetë (13), ndërsa më datë 29.03.2021 Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore ka njoftuar ankuesen së planifikimet buxhetore për këtë vit janë përfunduar, dhe se kërkesa për ngritje të koeficientit do të trajtohet në faza tjera. Ankuesja serish më datë 25.05.2022 i është drejtuar me kërkesë të njëjtë Udhëheqësit të Departamenti për Burime Njerëzore, ndërsa në përgjigje të kërkesës së ankueses Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore më datë 18.07.2022 njofton ankuesen në emër të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së se: *"jemi në proces të riorganizimit të brendshëm dhe sistematizimit të administratës në Sistemin Prokurorial të Kosovës dhe të gjitha kërkesat do të trajtohen gjatë këtij procesi"*

Ankuesja më datë 25.07.2022 parashtroi ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të mos harmonizimit të koeficientit të pagës. Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave më Vendimin KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e ankueses të datës 25.07.2022. E pa kënaqur më këtë vendim, ankuesja brenda afatit ligjor parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së vendimi i atakuar është nxjerrë si rezultat i aplikimit të gabuar të ligjit material, shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative si dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike. Me tej ankuesja thekson së Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimet ankimore, duke kërkuar që Këshilli të anuloi vendimin KA Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 dhe të obligojë Këshillin Prokurorial të Kosovës që të harmonizoj koeficientin në raport me pozitën Udhëheqës i Zyrës Ligjore dhe Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun nga data 23.09.2020.

Kolegji i Këshillit në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore ka analizuar Vendimin KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti bazohet në vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim jo të drejtë të dispozitave materiale, pasi që sipas vlerësimit të Kolegjit, Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave fare nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore duke e hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e ankueses të datës 27.05.2022 me arsyetimin së e njëjta më datë 02.09.2019 ka nënshkruar Akt Emërimit ndërsa ankesën në KZKA e ka parashtuar më datë 25.07.2022, përkatësisht Kolegji i Këshillit konstaton që ankuesja nuk ka kundërshtuar Aktin e Emërimit të datës 02.09.2019 nga nënshkrimi i të cilit do të llogaritej rrjedhja e afatit të pranueshmerisë së ankesës, por njëjta kërkon harmonizim të koeficienti të pagës me pozitën e tjera të aprovuar sipas Vendimit KPK/nr.450/2020 të datës 23.09.2020 të Këshillit Prokuroria të Kosovës.

Sipas nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative një ankesë është e pa pranueshme për këto arsye: 1.1 nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtuar brenda afatit të parashikuar

nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, e mbi këtë bazë Kolegji konstaton së ankesa e ankueses e datës 25.07.2022 ka qenë e afatshme pasi që ankuesja parashtron ankesë pas përgjigjes së datës 18.07.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore e më të cilën nuk ishte aprovuar kërkesa e ankueses për harmonizim të koeficientit dhe së afati i parashtrimit të ankesës ka filluar të rrjedhe nga data e njoftimit të ankueses me këtë përgjigje. Ndërlidhur me këtë e në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton së një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe materiale dhe si rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë të kundërligjshme është akt administrativ i paligjshme dhe si i tillë nuk krijon pasoja juridike.

Andaj, duke që së vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritorie lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me detyrimin që i njëjti të shqyrtoj ankesën e palës ankuese të datës 25.07.2022 dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2. dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda më numër A.nr.747/2022

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional



**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit

#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së